

Mbetjet e Ngurta Urbane, 2021


Tiranë, më 22 Shtator 2022: Në vitin 2021 rezulton të jenë menaxhuar rreth 875,105 mijë tonë mbetje urbane. Sasia vjetore e mbetjeve urbane të menaxhuara për banorë, në shkallë vendi, në vitin 2021 është 311 kg/banor, nga 369 kg/banor që ishte në vitin paraardhës¹.

Tab.1 Mbetje urbane të menaxhuara gjithsej dhe për banor rezident

Vitet	Tonë	Menaxhuar Gjithsej	Mbetje jo urbane	Mbetje Urbane
		Kg/Ban/Vit	Kg/Ban/Vit	Kg/Ban/Vit
2019	1.086.692	381	50	331
2020	1.047.852	369	64	305
2021	875.105	311	43	268

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT

Fig. 1 Mbetje urbane të menaxhuara për banor sipas burimeve gjeneruese (kg/banor)



¹ Për më shumë informacion lutem referohuni seksionit "Metodologjia" fq. 4

Në vitin 2021 sasia e mbetjeve jo urbane të menaxhuara bashkë me ato urbane është 13,8 % ndaj sasisë gjithsej, nga 17,2 % që ka qënë në 2020, duke shënuar një rënie me 3,4 %.

Tab. 2 Mbetje të menaxhuara sipas origjinës gjeneruese

Vitet	Mbetje tipike familjare dhe të ngjashme me to		Mbetje industriale menaxhuar bashkë me ato urbane	
	Tonë	%	Tonë	%
2019	945.024	87,0	141.668	13,0
2020	867.522	82,8	180.330	17,2
2021 ¹	754.094	86,2	121.011	13,8

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT


Niveli i mbulimit të popullatës me shërbime komunitare për menaxhimin e mbetjeve urbane në vitin 2021 është 88,8 %, duke shënuar një rritje me 1,9 %, krahasuar me vitin paraardhës.

Tab. 3 Shkalla e mbulimit të popullatës me shërbime për menaxhimin e mbetjeve

Vitet	Popullsia (rezidente)	Banorë rezidentë të shërbyer	Shkalla e mbulimit
	në vite	për mbetjet	me shërbime
	Banorë	Banorë	%
2019	2.854.191	2.508.834	87,9
2020	2.837.849	2.467.186	86,9
2021	2.811.666	2.497.473	88,8

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT

Fig. 2 Shkalla e mbulimit të popullatës me shërbime për menaxhimin e mbetjeve (%)



Në përbërjen e mbetjeve urbane komponent kryesor janë mbetjet organike. Në vitin 2021 mbetjet organike përbëjnë rreth 58,6 % të sasisë gjithsej të mbetjeve, kundrejt 58,5 % që ky tregues ishte në vitin 2020.

Tab. 4 Përbërja e mbetjeje urbane të menaxhuara (%)

Vitet	Mbetje. Organike	Druri	Letër, karton	Qelq	Plastikë	Tekstile	Metale	Mb. të rrezik. jo spitalore	Elek. PC etj	Inerte	Të tjera	Mbetje spitalore
2019	58,4	2,4	7,6	3,2	9,0	5,6	1,8	0,1	1,4	7,7	1,7	1,1
2020	58,5	4,6	7,2	4,3	8,5	3,7	1,6	0,6	0,1	8,9	2,0	0,08
2021	58,6	3,7	8,5	4,6	8,7	4,0	2,2	0,2	0,4	6,3	2,6	0,14

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT

Në vitin 2021 u depozituan rreth 79 % e sasisë totale të mbetjeje në landfille dhe fusha mbetjesh, ndërkohë që në vitin 2020 u depozituan 80,2 %, duke shënuar një rënie rreth 1,2 % të sasisë gjithsej të depozitimeve në landfille dhe fusha mbetjesh të miratuara si depozita të përkohëshme nga bashkitë përkatëse.

Në vitin 2021 u ricikluan 18,8 % e sasisë gjithsej të mbetjeje, ndërkohë që në vitin e kaluar ky tregues ishte 18,1 %. Në vitin 2021 janë trajtuar me djegie në incenerator për eliminim dhe qëllime energjetike rreth 2 % e sasisë gjithsej të mbetjeje, duke shënuar kështu rritje të këtij treguesi me 0,9 %, krahasuar me të njëjtin tregues në vitin 2020.

Tab. 5 Trajtimi i mbetjeje urbane

Vitet	Djegje për energji		Djegje për eliminim		Riciklime		Depozitime në landfille		Hedhje jashtë landfillit	
	Tonë	%	Tonë	%	Tonë	%	Tonë	%	Tonë	%
2019	9.732	0,9	1.744	0,2	203.440	18,7	847.208	78,0	24.538	2,3
2020	11.150	1,1	896	0,1	189.871	18,1	840.658	80,2	5.278	0,5
2021	17.189	2,0	311	0,04	164.444	18,8	691.352	79,0	1.811	0,2

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT

Në vitin 2021, janë gjeneruar gjithsej rreth 955 mijë tonë mbetje urbane, ndërkohë në vitin 2020 kjo shifër ishte rreth 1,1 milionë tonë. Mbetjet të pa menaxhuara në raport me sasinë totale të mbetjeje të gjeneruara në vitin 2021 janë 2,3 % më pak se në vitin 2020.

Tab. 6 Mbetje urbane të gjeneruara gjithsej dhe shkalla e menaxhimt të tyre

Vitet	Mbetje të menaxhuara		Mbetje të pa menaxhuara		Mbetje totale të gjeneruara
	Tonë	%	Tonë	%	Tonë
2019	1.086.692	90	114.898	10	1.201.598
2020	1.047.852	89,3	125.877	10,7	1.173.730
2021	875.105	91,6	80.685	8,4	955.790

Burimi: Bashkitë / Përpunimi INSTAT

Metodologjia

Deri në vitin 2018 statistikën mbi “Mbetjet e Ngurta Urbane në Shqipëri” mbështeteshin në të dhëna të mbledhura në terren nëpërmjet anketës vjetore mbi mbetjet urbane pranë subjekteve që ushtronin veprimtarinë e mbledhjes dhe menaxhimit të tyre. Në vitin 2020, INSTAT për mbledhjen e të dhënave mbi mbetjet e ngurta urbane referuar vitit 2019, ka aplikuar për herë të parë metodën inovative nëpërmjet pyetësorëve elektronikë “online” pranë gjithë bashkive të vendit.

Në vitin 2021 me vendimin Nr.538, date 22.09.2021 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve” Njësitë e vetëqeverisjes vendore zbatojnë metodologjinë për grumbullimin, gjenerimin dhe përpunimin e të dhënave për menaxhimin e mbetjeve, sipas shtojcës 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për plotësimin e formatit të raportimit të statistikave vjetore të mbetjeve për mbetjet e krijuara në territorin e tyre. Aplikimi i kësaj metodologjie sjell përmirësim cilësor dhe sasior të informacionit të ardhur nga burimi administrativ, duke aplikuar metoda për një përcaktim më të saktë të:

1. Numri i popullsisë rezidente të shërbyer për mbetjet;
2. Sasia e mbetjeve të prodhuara për person;
3. Sasia e mbetjeve shtëpiake të prodhuara në bashki.

Duhet theksuar se aplikimi i metodologjisë së sipër përmendur, i bën disa nga indikatorët e llogaritur në këtë publikim të pakrahasueshëm me serinë kohore.

Mbetjet e ngurta urbane depozitohen në kazanët e grumbullimit të mbetjeve dhe në vendin tonë, ato mbledhen përgjithësisht të pandara sipas llojit dhe në shumë raste në po të njëjtin vend hidhen edhe mbetje industriale që rezultojnë nga prodhime dhe shërbime të subjekteve të vogla biznesi në territorin urban.

Në këtë publikim jepen statistika vjetore për mbetjet e ngurta urbane në Shqipëri për:

- Mbetje të menaxhuara me fonde publike në total dhe referuar banorëve rezidentë sipas viteve.
- Sasia e mbetjeve të menaxhuara ndarë sipas burimeve kryesore gjeneruese.
- Shkalla e mbulimit të popullatës rezidente me shërbime komunitare për menaxhimin e mbetjeve urbane.
- Përbërja relative e mbetjeve të menaxhuara sipas materialeve dominuese përkundrejt totalit.
- Trajtimi i mbetjeve në sasi dhe përqindje sipas mënyrave kryesore të trajtimit.
- Mbetjet totale të gjeneruara në shkallë vendi dhe mbetjet e pa menaxhuara me fonde publike.

Mbetje të ngurta urbane, sipas përcaktimeve në legjislacionin Evropian, konsiderohen çdo substancë e ngurtë ose objekt që zotëruesi i tyre është i interesuar t'i braktisë dhe dëshiron ose është i detyruar t'i hedhë ato. Zotëruesi, këto materiale fizike, i largon nga vetja e tij duke humbur kështu çdo interes konkret për për këto substanca apo objekte, pavarësisht vlerave që mund të bartin ato në momentin e braktisjes.

Informacioni mbi mbetjet e ngurta urbane në Shqipëri është vjetor dhe i përgjithësuar në shkallë vendi. Të dhënat e paraqitura në këtë publikim janë mbledhur në terren nëpërmjet intervistimit online me pyetësor elektronik të personelit që merret me menaxhimin e mbetjeve në bashkitë përkatëse.

Mbetjet e ngurta urbane, objekt i këtij publikimi, janë mbetjet e ngurta familjare dhe mbetjet e tjera të ngjashme me to, të cilat vijnë nga shërbimet komunitare ndaj popullatës në zonat e banuara, qoftë dhe përkohësisht. Statistikat e mbetjeve urbane u referohen të dhënave vjetore të përgjithësuara në nivel vendi për prodhimin e treguesve statistikorë standard, sipas përcaktimeve në legjislacionin shqiptar dhe atë evropian, duke implementuar të njëjtat klasifikime dhe përkufizime sipas rregulloreve përkatëse.

Statistikat mbi mbetjet urbane janë subjekt revizionimi dhe përmirësimi, me të dhëna dhe fakte të reja nëse ato regjistrohen pas këtij publikimi. Për më shumë referohuni në linkun: <http://instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/>

Prodhimi dhe publikimi i statistikave mbi mbetjet e ngurta urbane bazohet në:

Legjislacioni Shqiptar:

- Ligj Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”.

Programin të Statistikave Zyrtare të Shqipërisë:

- Programin e Statistikave Zyrtare të Shqipërisë në periudhën 2017 - 2021.

Legjislacionin e BE-së

- Rregullorja Nr 2150/2002 mbi “Statistikat e mbetjeve”.
- Direktiva e Këshillit të Evropës Nr. b2008/98/EC për “Mbetjet dhe raportimin e detyrueshëm të statistikave për mbetjet”.
- Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 782/2005, që përcakton formatin e detyrueshëm për transmetimin e rezultateve në statistikat e mbetjeve.
- Rregullorja e Komisionit Evropian Nr. 783/2005, Shtojca II për rregulloren e mbetjeve.
- Direktiva e Këshillit të Evropës Nr. 2150/2002 për “Kriteret e duhura të vlerësimit të cilësisë dhe përmbajtjen e raporteve të cilësisë për statistikat e mbetjeve”.
- Rregullorja e Komisionit Evropian 849/2010 për “Menaxhimin e mbetjeve urbane”.
- Manuali i Statistikave për Mbetjet 2013 i amenduar, Publikim i Eurostat, viti 2013.

Definicione

Mbetje të menaxhuara me fonde publike në total dhe referuar banorëve rezidentë janë: Mbetjet të cilat menaxhohen nën kujdesin e organeve të pushtetit vendor, financuar si shërbime nga buxheti i tyre për banorët vendas dhe të tjerë rezidentë në territorin e tyre administrativ.

Sasia e mbetjeve të menaxhuara ndarë sipas burimeve kryesore gjeneruese është: Sasia totale e mbetjeve të menaxhuara ndarë në mbetje të ngurta urbane, të cilat janë mbetje familjare dhe ato të shërbimeve komunitare, dhe mbetjet industriale të cilat depozitohen dhe për pasojë menaxhohen bashkë me mbetjet urbane.

Shkalla e mbulimit të popullatës rezidente me shërbime komunitare për menaxhimin e mbetjeve urbane është: Sasia në % e popullatës, me banim të përhershëm dhe të përkohshëm në një territor të caktuar, për mbetjet e të cilëve ofrohet shërbimi i duhur në të gjitha fazat e menaxhimit të tyre, financuar nga fondet publike.

Përbërja relative e mbetjeve të menaxhuara sipas materialeve dominuese përkundrejt totalit është:

Përqindja në peshë që zë lloji i mbetjes së emërtuar përkundrejt sasisë totale të mbetjeve.

Trajtimi i mbetjeve në sasi dhe përqindje sipas mënyrave kryesore të trajtimit shpreh destinacionin final të mbetjeve, grupuar sipas mënyrave standarde të trajtimit.

Mbetjet totale të gjeneruara në shkallë vendi dhe mbetjet të pa menaxhuara me fonde publike janë: Mbetjet urbane të menaxhuara me fonde publike dhe mbetjet që menaxhohen nga vetë burimet gjeneruese privatisht. Mbetjet që menaxhohen privatisht nga burimet gjeneruese rezultojnë si deduksion matematik mes mbetjeve të menaxhuara për banor dhe shkallës së mbulimit të banorëve rezidentë me shërbime komunitare për mbetjet.

Struktura e subjekteve që menaxhojnë mbetje nënkupton përqindjen që zënë subjektet e klasifikuara sipas statusit të tyre juridik në totalin e subjekteve që kanë menaxhuar mbetje në vitet përkatëse.

Mbetjet totale të gjeneruara përbejnë sasinë teorike të mbetjeve urbane prodhuar nga aktiviteti njerëzor në vitin përkatës. Ky tregues i referohet mbetjeve të menaxhuara në zonat ku ky aktivitet kryhet si shërbim komunitar ndaj publikut dhe sasisë tjetër të mbetjeve të cilat menaxhohen nga vetë banorët pasi nuk mbulohen nga shërbimet publike për mbetjet. Sasia e mbetjeve totale të gjeneruara në këtë rast vjen si kalkulim teorik i mbetjeve totale të gjeneruara nga banorët, bazuar në treguesin e mbetjeve të menaxhuara për banor rezident në vit dhe në shkallën e mbulimit të banorëve me shërbime për mbetjet në vitin përkatës.